



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Seksioni i Veçantë

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 202100598/2

Tiranë \_\_\_ / \_\_\_ /2021

**Lënda:** *Rekomandim për marrjen e masave ndaj punonjësve të Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë për mohimin e të drejtës së mbrojtjes për protestuesit e Thirrës, si një standard i parashikuar dhe garantuar nga neni 6 § 3 i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut.*

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË POLICISË SË SHTETIT  
TIRANË

*Të nderuar,*

Avokati i Popullit në përmbushje të misionit të tij kushtetues e ligjor për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit, nga veprimet dhe mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, ka filluar trajtimin me iniciativë të problematikave dhe shqetësimeve që kanë lindur gjatë dhe pas protestës së ndërmarrë nga një numër individësh në afërsi të Thirrës/Mirditë, në mbështetje të një çështjeje për mbrojtjen e ambientit për shkak të ndërhyrjeve që janë ndërmarrë në kuadër të ndërtimit të një hidrocentrali.

Sipas raportimeve në media, kjo ishte protesta e dytë e banorëve të fshatrave Thirrë dhe Sang në Mirditë, të cilët kundërshtojnë ndërtimin e një HEC-i dhe një fabrike uji në këtë zonë. Në protestën e ditës së dielë, datë 11 prill 2021, atyre iu bashkuan një sërë organizatash mjedisore, dy deputetë të LVV nga Kosova, kandidati i pavarur por i mbështetur nga Lëvizja Vetëvendosja në Lezhë, si edhe aktivistë<sup>1</sup>.

<sup>1</sup> Shih burimin e informacionit <https://www.reporter.al/protesta-kunder-hec-ne-thirre-policia-ndalon-33-pjesemarres/>

Paraprakisht theksojmë faktin se gjatë periudhës kohore 2018-2020, institucioni i Avokatit të Popullit, në mënyrë më të intensifikuar për shkak të dinamikës së krijuar, ka filluar e ndjekur me nismën e vet disa raste të bëra publike në media për ushtrimin e lirisë së tubimit, si dhe ka monitoruar pothuajse të gjitha tubimet e organizuara nga subjekte politike dhe grupime qytetarësh; të banorëve tek “Unaza e Re”, zona e “Astirit” dhe në zonën pranë “Bregut të lumit” Tiranë për prishjet e objekteve të tyre për shkak të zbatimit të projektit të zgjerimit të “Unazës së Re” dhe të zgjatimit të Bulevardit “Zogu i Parë”; të studentëve të cilët kanë protestuar respektivisht ndaj Institucioneve Publike të Arsimit të Lartë për kushte më të mira në universitete; të aktivistëve të shoqërisë civile dhe qytetarëve të ndryshëm për shkak të masave kufizuese të vendosura nga autoritetet shtetërore gjatë periudhës së pandemisë për shkak të virusit Covid-19, etj.

Në përfundim të shqyrtimit të tyre, në disa raste nga Avokati i Popullit është konstatuar se kjo e drejtë nuk respektohet gjithmonë nga organet e Policisë së Shtetit në përputhje me standardet ndërkombëtare apo frymën e ligjit vendas. Këto të fundit jo vetëm që nuk kanë kontribuar në realizimin e saj, por ndonjëherë janë bërë edhe pengesë duke e cenuar këtë të drejtë themelore kushtetuese të shtetasve. Për këto arsye në vijimësi janë bërë disa rekomandime organeve të Policisë së Shtetit<sup>2</sup>.

Në rekomandimet e dërguara Avokati i Popullit ka vlerësuar se është mëse e nevojshme që qytetarët të nxiten që t’i ushtrojnë të drejtat e tyre, por edhe t’ua rikujtojnë institucioneve detyrimet e tyre ligjore për përgjigjet ndaj këtyre kërkesave që në thelb pasqyrojnë kapacitetin demokratik të shoqërisë në përgjithësi.

Duke iu rikthyer çështjes së protestës në Mirditë, në përmbushje të detyrave tona funksionale, nga ana e një grupi të ngritur nga Avokati i Popullit me datë 12 prill 2021 është kryer një inspektim në ambientet e Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë, ku kemi marrë takim me Drejtues të këtij institucioni. Gjithashtu, nga ana jonë është marrë kontakt edhe me personat e shoqëruar dhe që gjendeshin në ambientet e dhomave të sigurisë, në pritje të vlerësimit të masës së arrestit dhe dhënies së masës së sigurisë nga Gjykata, pasi ndaj 4 personave ishte vendosur masa e arrestit, nga të cilët 3 prej tyre ishin me origjinë nga Kosova. Siç rezultoi në ditët në vijim, në limitet e hapësirave kohore ligjore për verifikimin dhe vlerësimin e masave paraprake, Gjykata e Lezhës ka liruar nga qelia katër personat e arrestuar, të cilët protestuan për ndalimin e ndërtimit të HEC-it të Mirditës.

Togat e zeza kanë vendosur masën e sigurisë “*detyrim paraqitje*” për shtetasin B.P., si edhe tre aktivistët e lëvizjes Vetëvendosje në Shqipëri E.B., E.B. dhe Ç.G.<sup>3</sup>

Sipas informacioneve paraprake, rezultonte se në ambientet e sigurisë pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë ishin shoqëruar rreth 33 persona, pjesëmarrës në tubimin e

<sup>2</sup> Shih ndër të tjera edhe Rekomandimin e Avokatit të Popullit dërguar me shkresën tonë me nr. K2/118-4 prot. datë 21.07.2020 Prokurorit të Përgjithshëm, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë dhe Komitetit Ndërmintor të Emergjencave Civile.

<sup>3</sup> Shih <https://dosja.al/protesta-per-hec-in-ne-mirdite-gjykata-e-lezhes-merr-vendimin-per-kater-te-arrestuarit-perfaqesuesi-i-tyre-prokuroria-kerkoi-burg-pasi-paci-konsiderohet-i-rrezikshem/>

organizuar në afësi të fshatit Thirrë. Shqetësimi kryesor i ngritur nga ana e tyre, por edhe organizata politike që i mbështeste ato gjatë tubimit të organizuar, ishte mungesa e kontaktit me përfaqësuesit ligjorë gjatë procedurave të marrjes së deklarimeve dhe plotësimit të materialeve e dokumentacioneve nga ana e oficerëve të policisë gjyqësore.

Gjithashtu u ngrit edhe pretendimi dhe shqetësimi lidhur me ndalimin dhe shoqërimin e tyre pas mbarimit të tubimit të organizuar, pasi ndaj tyre ishte vendosur masa e arrestit në flagrancë, ndërkohë që nuk plotësohet asnjë kriter ligjor për vendosjen e një mase të tillë.

Avokati i Popullit vlerëson paraprakisht faktin se nga ana e strukturave të Policisë është vepruar dhe është vendosur masa e shoqërimit për një numër shumë të lartë të pjesëmarrësve në këtë tubim, pavarësisht faktit se nga ana e tyre është bllokuar vetëm për disa minuta edhe vetëm një pjesë e rrugës së kombit, në shenjë sensibilizimi dhe ndërgjegjësimi të opinionit publik për një çështje serioze mjedisore dhe me një impakt shumë të madh për zonën dhe komunitetin e banorëve të saj.

Kjo situatë u rëndua dhe përkeqësua edhe më tej pasi Kandidati i Pavarur i mbështetur nga Lëvizja Vetëvendosje në Qarkun e Lezhës, shtetasi I.Sh., u gjobit nga policia për shkelje të masave anti COVID-19. Gjoha me vlerë 5 milion lekë të reja u vendos për tubimin e zhvilluar me 11 prill para Komisarariatit të Policisë në Lezhë në mbështetje të 4 aktivistëve të arrestuar, pas protestës së zhvilluar kundër ndërtimit të një HEC-i dhe fabrike uji në Thirrë të Mirditës<sup>4</sup>.

Në këtë aspekt, mund t'i referohemi parimit të proporcionalitetit, i cili kërkon që çdo shkelje e të drejtave të individit të jetë e kufizuar në masën që është e përshtatshme dhe e nevojshme për arritjen e një qëllimi legjitim. Kur masa kufizon një të drejtë të mbrojtur sipas Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (OCCPR), organet shtetërore *“duhet të demonstrojnë domosdoshmërinë e tyre dhe të marrin vetëm masa të tilla që janë proporcionale me ndjekjen e qëllimeve legjitime në mënyrë që të sigurohet mbrojtje e vazhdueshme dhe efektive e të drejtave të parashikuara nga Konventa”*, përfshirë të drejtën për liri<sup>5</sup>. Komiteti për të Drejtat e Njeriut ka sqaruar se *“masat kufizuese duhet të jenë në përputhje me parimin e proporcionalitetit; ato duhet të jenë të përshtatshme për tu arritur funksioni i tyre mbrojtës; ato duhet të jenë instrumenti më pak ndërhyrës midis atyre që mund të jenë të arrijë rezultatin e dëshiruar; dhe ato duhet të jenë në përpjesëtim me interesin për t'u mbrojtur.”*<sup>6</sup> Parimi është reflektuar gjithashtu në jurisprudencën ndërkombëtare, të tilla si Gjykata ndër-amerikane e të Drejtave të Njeriut<sup>7</sup>.

<sup>4</sup> Shih <https://www.reporter.al/policia-e-lezhes-akuzohet-se-gjobiti-kandidatin-e-pavarur-ne-menyre-selektive/>

<sup>5</sup> Human Rights Committee (2004), General comment No 31 on the nature of the general legal obligation.

<sup>6</sup> Human Rights Committee (1999), General comment No 27 on freedom of movement (Article 12), U.N. Doc CCPR/C/21/Rev.1/Add.9

<sup>7</sup> Gjykata ka vendosur, në kontekstin e dënimit, që “askush nuk mund t'i nënshtrohet arrestimit ose burgosjes për arsye dhe me metoda të cilat, megjithëse klasifikohen si të ligjshme, mund të konsiderohen të papajtueshme me respektimin e të drejtat themelore të individit sepse, ndër të tjera, ato janë të paarsyeshme,

Në lidhje me politikat e dënimit, parimi i proporcionalitetit kërkon një gamë të disponueshme të opsioneve të dënimit dhe se dënimet me burg aplikohen vetëm kur nuk do të kishte asnjë sanksion tjetër, proporcional me seriozitetin e veprës dhe natyrën e kryerjes së saj, duke marrë parasysh çdo faktor rëndësues dhe lehtësues.

Avokati i Popullit ka tërhequr vëmendjen e autoriteteve ligjzbatuese që në ushtrimin e detyrës të ruajnë me çdo kusht kriteret e proporcionalitetit në çdo vendim dhe masë që ndërmarrin për shoqërimin e çdo qytetari që rezulton të mos ketë kuptim të qartë apo të njëjtë me atë të tyre në lidhje me masat kufizuese të vendosura në rastin e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në vendin tonë.

Qëllimi i këtyre masave s'mund të jetë heshtja e zërit ndryshe apo mospajtuës me politikat e qeverisë. E kundërta është e vërtetë. Besimi i qytetarëve dhe më gjerë, se masat janë të duhurat dhe proporcionale dhe se zbatimi i tyre ka të vetmin qëllim, ruajtjen e të drejtës së jetës së tyre, është provuar të sjellë rezultat shumë më të mirë se dhjetëra apo qindra gjoba.

Askush nuk mund të pajtohet me retorikën se masat ekstreme ndaj qytetarëve kanë qëllim fundor mbrojtjen e jetës së qytetarëve prej pandemisë, nëse gjatë zbatimit të këtyre masave, shëndeti, siguria, mirëqenia dhe garancia e jetës në një vend të lirë për qytetarët, cënohen po aq keq sa do të ishin cënuar edhe nga vetë prekja prej virusit pandemik.<sup>8</sup>

Sipas qëndrimit të Grupit të Punë të OKB kundër Ndalimit Arbitrar, *“Të gjitha masat e paraburgimit duhet të jenë të justifikuara, adekuate, të nevojshme dhe proporcionale me qëllimin e kërkuar”*<sup>9</sup>.

Avokati i Popullit konstaton se një nga shqetësimet kryesore dhe thelbësore të parashtruara nga protestuesit dhe përfaqësuesit e tyre ligjorë, ishte edhe mungesa e kontakteve dhe e garantimit të ndihmës ligjore që në momentet e para të shoqërimit të një numri shumë të lartë të protestuesve në ambientet e Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë. Për shkak të mohimit të kontakteve dhe refuzimit të vazhdueshëm të punonjësve dhe strukturave të tjera të policies, Grupi i Përfaqësuesve ligjorë i përbërë nga katër Avokatë ka depozituar një kërkesë me shkrim rreth orës 20<sup>00</sup> të datë 11 prill 2021, kërkesë e cila është protokolluar, por nuk kishte marrë asnjë përgjigje zyrtare. Ndërkohë që vetëm në orët e vona të darkës, rreth mesnatës, është lejuar kontakti i vetëm dy prej të arrestuarve me përfaqësuesen ligjore, pasi shtetasit e tjerë ishin në gjumë, pas orëve të gjata të dhënies

---

të paparashikueshme ose mungojnë proporcionaliteti”, Gjykata Ndër-Amerikane e të Drejtave të Njeriut, Rasti Gangaram Pandey, 21 janar 1994, para. 48.

<sup>8</sup> Shih qëndrimin e institucionit të Avokatit të Popullit në <https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/articles-layout-1/home/news/this-article-is-available-only-in-albanian-487/>

<sup>9</sup> Report of the Working Group on Arbitrary Detention, A/HRC/27/48, 30 June 2014, para 88.

së deklarimeve para Oficerit të Policisë Gjyqësore që kishte kryer veprimet respektive me të shoqëruarit.

Duhet të theksojmë faktin se e drejta e mbrojtjes ligjore me Avokat është një standard i parashikuar dhe garantuar nga neni 6 § 3 i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Ky parim dhe standard, është elaboruar dhe interpretuar gjerësisht tashmë edhe në jurisprudencën e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut në Strasburg. Shqipëria është shtet anëtar i Këshillit të Europës, ka ratifikuar Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe jurisprudenca e GJEDNJ është tashmë pjesë e rendit tonë të brendshëm juridik, i detyrueshëm për tu zbatuar dhe respektuar nga të gjitha organet shtetërore.

Kështu, në çështjen *Salduz kundër Turqisë*<sup>10</sup>, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut vlerësoi se kishte pasur një shkelje të Neni 6 § 3 (c) (e drejta për ndihmë juridike) marrë së bashku me nenin 6 § 1 (e drejta në një gjykim të drejtë) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ajo zbuloi se edhe pse aplikanti kishte qenë në gjendje të kundërshtonte akuzat në gjyqin e tij, faktin që ai nuk mundi të ndihmohet nga një avokat ndërsa ishte në paraburgim policer, kishte ndikuar në mënyrë të pakthyeshme në mbrojtjen e të drejtave të tij.

Gjykata Evropiane ka konstatuar që në mënyrë që e drejta për një gjykim të drejtë sipas Neni 6 § 1 të mbetet mjaftueshëm “*praktike dhe efektive*”, qasja tek një avokat duhet të sigurohet, si rregull, edhe në intervistën e parë policore e një të dyshuari, përveç nëse mund të demonstrohej në dritën e rrethanave të veçanta të një çështjeje të caktuar se kishte pasur arsye bindëse për të kufizuar këtë të drejtë. Edhe kur arsyet bindëse përjashtimisht mund të justifikojnë mohimin e hyrjes në një avokat, një kufizim i tillë - pavarësisht nga justifikimi i tij - nuk duhet të ketë paragjykuar padrejtësisht të drejtat e të akuzuarit sipas neni 6 të KEDNJ. Të drejtat e mbrojtjes në parim do të paragjykojnë në mënyrë të pakthyeshme kur deklaratat inkriminuese bëhen gjatë një interviste policie pa qasje te një Avokat, si edhe përdoren si bazë për një dënim.

Gjithashtu në çështjen *Pishchalnikov kundër Rusisë*<sup>11</sup>, Gjykata vendosi se kishte pasur një shkelje të neni 6 § 3 (c) në lidhje me nenin 6 § 1 të Konventës. Ajo zbuloi se mungesa e ndihmës juridike për aplikantin në fazat fillestare të pyetjeve policore kishte ndikuar në mënyrë të pakthyeshme në të drejtat e tij të mbrojtjes dhe minoi mundësinë që ai të kishte një gjykim të drejtë. Gjykata konsideroi se dëmi i shkaktuar të drejtave të kërkuarit, pasi nuk kishte një avokat gjatë marrjes në pyetje fillestare të policisë, ishte i një niveli të tillë sa që nuk ishte e nevojshme të shqyrtohej më tej fakti nëse ai ishte ndihmuar në mënyrë efektive nga një avokat në fazat e mëvonshme të procedurës.

<sup>10</sup> Vendim i Dhomës së Madhe të GJEDNJ datë 27.11.2008, aplikimi nr. 36391/02, shih <https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22itemid%22:%5B%22003-2565368-2783076%22%5D%7D>.

<sup>11</sup> Shih <https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22itemid%22:%5B%22003-2870722-3150661%22%5D%7D>, aplikimi 7025/04, vendim i datës 24.09.2009.

Edhe në çështjen *Dayanan kundër Turqisë*<sup>12</sup>, Gjykata vendosi që kishte pasur një shkelje të Nenit 6 § 3 (c) të marrë së bashku me 6 1 të Konventës. Ajo zbuloi se ai kufizim (i cili ishte sistematik, siç ishte përshkruar nga dispozitat përkatëse të ligjit turk) të së drejtës së një individi të privuar nga liria për të pasur qasje te një avokat ishte i mjaftueshëm që ai të mund të konkludonte se kishte pasur shkelje të nenit 6 të Konventës, edhe pse kërkuesi kishte heshtur ndërsa ishte në paraburgim policor.

Nga ana tjetër, ky standard ndërkombëtar, është pasqyruar dhe reflektuar edhe në Procedurat Standarde të Punës për Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit, miratuar me Urdhërin nr. 938 datë 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë. Në pikën VII/1 gërma “e” parashikohet konkretisht se: Personi i shoqëruar ka të drejtë të komunikojë me një person të besuar, avokat apo mbrojtësin ligjor.

Siç rezulton konkretisht nga deklaratimet publike dhe mediatike, deklaratat e përfaqësuesve ligjorë të administruara tashmë nga Avokati i Popullit, regjistri i takimit të Avokatit me të ndaluarit/arrestuarit, si edhe deklaratimet e katër personave të arrestuar për shkak të protestës në Mirditë, kjo e drejtë dhe garanci ligjore u është mohuar që në momentet e para të shoqërimit në ambientet e Komisarariatit të Policisë Lezhë dhe deri në orët e vona të natës.

Nga ana tjetër, Avokati i Popullit vlerëson dhe thekson se e drejta themelore e njeriut për tubim paqësor u mundëson individëve që të shprehen kolektivisht dhe të marrin pjesë në formësimin e shoqërive të tyre. E drejta e tubimit paqësor është e rëndësishme më vete, pasi mbron aftësinë e njerëzve për të ushtruar autonomi individuale në solidaritet me të tjerët. Së bashku me të drejtat e tjera që lidhen me lirinë politike, ajo gjithashtu përbën themelin e një sistemi të qeverisjes pjesëmarrëse të bazuar në demokraci, të drejtat e njeriut [sundimin e ligjit] dhe pluralizmin, ku ndryshimi ndiqet përmes bindjes sesa forcës. Tubimet paqësore mund të luajnë një rol kritik në lejimin e pjesëmarrësve të përparojnë idetë dhe qëllimet aspiruese në mjedisin publik, dhe të përcaktojnë shkallën e mbështetjes ose kundërshtimit të atyre ideve dhe qëllimeve. Tubimet paqësore mund të krijojnë mundësi për zgjidhje gjithëpërfshirëse pjesëmarrëse dhe paqësore të dallimeve.

E drejta e tubimit paqësor është, për më tepër, një mjet i vlefshëm që mund dhe është përdorur për realizimin e një game të gjerë të të drejtave të tjera të njeriut, përfshirë të drejtat socio-ekonomike. Mund të jetë me rëndësi të veçantë për anëtarët e marginalizuar dhe të hequr të drejtës së shoqërisë. Tubimi paqësor është një përdorim i ligjshëm i hapësirës publike. Mosnjohja e së drejtës për të marrë pjesë në tubimet paqësore është një shenjë e shtypjes.

Ndërkohë që Avokati i Popullit ka shprehur tashmë qëndrimin e tij në lidhje me ushtrimin e të drejtës/lirisë së tubimit nga qytetarët si një nga të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Sjellim në vëmendje se liria e tubimeve është parashikuar dhe garantuar nga Kushtetuta e

<sup>12</sup> Shih [https://hudoc.echr.coe.int/eng-press#{"itemid":\["003-2895533-3178515"\]}](https://hudoc.echr.coe.int/eng-press#{), aplikimi 7377/03, vendimi i datës 13.10.2009.

Republikës së Shqipërisë, Pjesa e II-të “Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut”, Kreu III “Liritë dhe të drejtat politike”, respektivisht në nenin 47 ku parashikohet se:

*“1. Liria e tubimeve paqësore dhe pa armë, si dhe e pjesëmarrjes në to është e garantuar.  
2. Tubimet paqësore në sheshe dhe në vendet e kalimit publik bëhen sipas procedurave të parashikuara me ligj”.*

Liria e tubimit dhe e organizimit, garantohet edhe nga neni 11 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, ku shprehimisht thuhet se:

*“1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së tubimit paqësor dhe të organizimit me të tjerët, duke përfshirë të drejtën e themelimit me të tjerë të sindikatave dhe të pjesëmarrjes në to për mbrojtjen e interesave të tij.*

*2. Ushtrimi i këtyre të drejtave nuk mund t'u nënshtrohet kufizimeve të tjera përveç atyre që parashikohen me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për ruajtjen e shëndetit ose të moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të të tjerëve....”.*

Sjellim në vëmendje që në nenin 122 të Kushtetutës parashikohet se:

*“1. Çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik pasi botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë. Ajo zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk është e vetëzbatueshme dhe zbatimi i saj kërkon nxjerrjen e një ligji. Ndryshimi, plotësimi dhe shfuqizimi i ligjeve të miratuara me shumicën e të gjithë anëtarëve të Kuvendit për efekt të ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare bëhet me të njëjtën shumicë.*

*2. Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të<sup>13</sup>.*

*3. Normat e nxjerra prej një organizate ndërkombëtare kanë epërsi, në rast konflikti, mbi të drejtën e vendit, kur në marrëveshjen e ratifikuar nga Republika e Shqipërisë për pjesëmarrjen në atë organizatë, parashikohet shprehimisht zbatimi i drejtpërdrejtë i normave të nxjerra prej asaj.”*

Rregullat procedurale që dispijlojnë apo kushtëzojnë ushtrimin e kësaj të drejte janë të përcaktuara në mënyrë të shprehur në ligjin nr. 8773, datë 23.4.2001 “Për tubimet”, ku parashikohen edhe kufizimet apo ndalimet shteruese të cilat nuk mund të tejkalohen në ushtrimin e së drejtës së tubimit. Ky ligj i cili ka dalë në bazë dhe në zbatim të nenit 47 të Kushtetutës pasi përcakton se, çdo person ka të drejtë të organizojë dhe të marrë pjesë në një tubim paqësor dhe pa armë, parashikon gjithashtu se Policia e Shtetit garanton dhe mbron të drejtën e çdo personi për të organizuar e marrë pjesë në tubime paqësore dhe pa armë. Ndalimi dhe shpërndarja e një tubimi lejohet vetëm në rastet e parashikuara me ligj.

<sup>13</sup> KEDNJ-ja është ratifikuar nga shteti shqiptar me ligjin nr. 8137, datë 31.07.1996

Nga referimi në përmbajtjen e dispozitave të këtij ligji rezulton në mënyrë të qartë se, detyrat e Policisë së Shtetit në lidhje me tubimet janë:

**Së pari**, kryerja e veprime dhe marrja e masave të nevojshme për garantimin e ushtrimit të kësaj të drejte/lirie themelore kushtetuese të shtetasve dhe mbarëvajtjen e tubimit;

**Së dyti**, ndalimi i ushtrimit të kësaj të lirie/të drejte bëhet vetëm për raste të kufizuara të cilat janë të përcaktuara në mënyrë qartë dhe shteruese në ligj. Ato nuk mund dhe nuk duhet të cenojnë thelbin e lirive dhe e të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në KEDNJ.

Për ushtrimin e kësaj të drejte kërkohet vetëm bërja e njoftimit në një kohë të përcaktuar i organeve të policisë ku të pasqyrohen disa të dhëna që lidhen me zbatimin e detyrës së saj si garantuese e ushtrimit të kësaj të drejte/lirie duke i dhënë kohe për të marrë masat e nevojshme për mbarëvajtjen e tubimit. Madje ligji aktual në nenin 7 parashikon edhe të drejtën e shtetasve për zhvillimin e tubimeve urgjente në rastet kur ka rrethana urgjente, i cili mund të zhvillohet pa respektuar afatin e parashikuar në nenin 5<sup>14</sup> të këtij ligji, por detyrimisht duhet të bëhet njoftimi me shkrim i cili përmban elementët e përcaktuar në nenin 5, pika 2 të këtij ligji, si dhe arsyen e urgjencës. Në këto raste njoftimi duhet të bëhet menjëherë, po jo më vonë se 3 orë përpara kohës së zhvillimit të tubimit.

Fakti që në ligjin aktual përdoret termi njoftim drejtuar Komisarariatit të Policisë për zhvillimin tubimit dhe jo kërkesë është me shumë rëndësi dhe domethënës në favor të ushtrimit dhe garantimit të kësaj të drejte/lirie nga shtetasit. Nëse në këtë ligj do të parashikohej termi kërkesë për zhvillimin e tubimit, kuptohet në mënyrë të qartë se për të bërë të mundur ushtrimin e kësaj të drejte/lirie do të duhej miratimi i organit të policisë, sikurse ishte në ligjin e mëparshëm. Ndërsa përdorimi në ligj i termit njoftim, do të thotë që “vendimin” për ushtrimin e të drejtës e ka marrë vetë subjekti njoftues dhe nuk kërkohet miratimi i organit të policisë. Pikërisht këtu qëndron ndryshimi thelbësor që ka sjellë ligji i vitit 2001 “Për tubimet”, për të garantuar ushtrimin real të kësaj të drejte/lirie themelore kushtetuese të shtetasve në një vend demokratik sikurse është edhe vendi ynë. Nëse njoftuesit nuk e bëjnë njoftimin me të dhënat e parashikuara dhe të kërkuara nga ligji, Shefi i Komisarariatit të Policisë ka të drejtën ligjore të komunikojë me organizatorin për plotësimin e të dhënave ose të marrë vendim të arsyetuar për ndalimin e tubimit në sheshe

<sup>14</sup> Në neni 5 të këtij ligji parashikohet se:

1. Në rast tubimi në sheshe ose vendkalime publike, organizatori dhe drejtuesi janë të detyruar **të njoftojnë** me shkrim shefin e komisarariatit të policisë jo më vonë se tri ditë para datës së zhvillimit të tubimit.

2. **Njoftimi** me shkrim duhet të përmbajë:

a) identitetin dhe adresën e drejtuesit dhe të organizatorit të tubimit;

b) qëllimin e tubimit;

c) datën, vendin, orën e fillimit dhe të përfundimit të tubimit dhe itinerarin e tij (nëse ka të tillë);

ç) numrin e përfaqësuesve dhe numrin e personave ndihmës në mbarëvajtjen e tubimit;

d) personat që do të flasin në tubim.

3. Në rast se njoftimi me shkrim nuk i përmban elementet e parashikuara në pikën 2 të këtij neni, ai i kthehet për plotësim organizatorit dhe drejtuesit të tubimit, të cilët duhet ta riparaqesin atë të plotësuar jo më vonë se 24 orë para kohës kur do të zhvillohet tubimi.



ose vendkalime publike, apo ndryshimin e vendit dhe të kohës së zhvillimit të tij. Është me rëndësi që të sjellim në vëmendje se fryma pozitive e ligjit aktual reflektohet në mënyrë të qartë edhe në nenin 12<sup>15</sup> të tij, ku parashikohet zhvillimi i tubimeve në vendet e hapura për publikun pa bërë njoftimin paraprak të policisë sipas parashikimeve të nenit 5.

Gjithashtu sqarojmë se fryma e ligjit “Për tubimet” është në përputhje edhe me qëndrimin e Komisionit të Venecias për të drejtën e tubimit. Ky Komision shprehet se:

“Duke pasur parasysh rëndësinë e lirisë së mbledhjes, është e rëndësishme që çdo kufizim t’i përmbahet asaj që është e lejueshme sipas ligjit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut. Kështu, kufizimet nuk duhet të shkojnë përtej asaj që përcaktohet në KEDNJ, Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike dhe traktatet e tjera përkatëse. Për më tepër, arsyet ekzistuese të përcaktuara në këto instrumente duhet të interpretohen ngushtë, për të siguruar mbrojtje maksimale për lirinë e tubimeve paqësore”<sup>16</sup>. Protesta në fjalë ka qenë një protestë paqësore e për këtë shkak nuk shihen shkaqe për një sjellje të tillë të policisë.

Është rasti të sjellim në vëmendje detyrimet e shtetit që burojnë nga neni 15/2 i Kushtetutës ku parashikohet se, “*Organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre*”. Në këtë kuadër, nga organet e pushtetit publik kërkohet që, jo vetëm të mos bëhen pengesë për ushtrimin e lirisë së tubimeve paqësore të shtetasve, por përkundrazi duhet të kontribuojnë për të lehtësuar dhe mbrojtur ushtrimin e së drejtës për lirinë e tubimit paqësor. Kjo detyrë duhet të pasqyrohet në kuadrin legjislativ, si dhe rregulloret dhe praktikat përkatëse të zbatimit të ligjit.<sup>17</sup>

Ndërkohë, neni 11 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut jo vetëm që mbron të drejtën e individit për tubim paqësor, duke sanksionuar kështu detyrimin negativ të shtetit për mosndërrhyrje, por në të njëjtën kohë përcakton edhe detyrimin pozitiv të autoriteteve shtetërore për të marrë masat e nevojshme për të lehtësuar ushtrimin e kësaj të drejte/lirie dhe për të mundësuar që grumbullimet apo manifestimet të bëhen në mënyrë paqësore.

Mbrojtja efektive e së drejtës për lirinë e tubimit paqësor mund të ndihmojë gjithashtu në nxitjen e një kulture të demokracisë së hapur, të mundësojë pjesëmarrje jo të dhunshme në çështjet publike dhe të forcojë dialogun për çështje me interes publik. Grumbullimet

---

<sup>15</sup> Në nenin 12 parashikohet se:

1. *Tubimet në vende të hapura për publikun mbahen edhe pa njoftimin paraprak të policisë, sipas nenit 5 të këtij ligji.*

2. *Organizatorët e këtyre tubimeve mund të kërkojnë mbështetjen e policisë jashtë këtyre vendeve, për të mënjanuar ç'rregullimet gjatë ose pas zhvillimit të tubimit.*

<sup>16</sup> *Guidelines on Freedom of Peaceful Assembly*, Doc. CDL-AD(2019)017, OSCE/ODIHR & Venice Commission, 8 July 2019.

[https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2019\)017-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2019)017-e)

<sup>17</sup> *Guidelines on Freedom of Peaceful Assembly*, Doc. CDL-AD(2019)017, OSCE/ODIHR & Venice Commission, 8 July 2019.

[https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2019\)017-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2019)017-e)

qytetare mund të ndihmojnë në sigurimin e përgjegjësisë së organeve publike dhe zyrtarëve qeveritarë dhe kështu të promovojnë qeverisjen e mirë në përputhje me sundimin e ligjit.

GJEDNJ në praktikën e saj ka konsideruar se njoftimi, dhe madje procedurat e autorizimit, për një ngjarje publike normalisht nuk shkelin mbi thelbin e së drejtës në bazë të nenit 11 të Konventës për sa kohë që qëllimi i procedurës është që të lejojë autoritetet të marrin masa të arsyeshme dhe të përshtatshme për të garantuar zhvillimin normal të çdo tubimi, mbledhje apo grumbullimeve të tjera<sup>18</sup>. Organizatorët e tubimeve publike duhet të veprojnë në përputhje me rregullat që rregullojnë këtë proces duke respektuar rregulloret në fuqi. Njoftimi paraprak i shërben jo vetëm qëllimit të bashkërendimit të të drejtës së tubimit me të drejtat dhe interesat e ligjshëm duke përfshirë lirinë e lëvizjes të të tjerëve, por gjithashtu qëllimit të parandalimit të trazirave apo krimit. Edhe në rastin kur nuk është bërë një lajmërim paraprak për protestë, ky element teknik nuk duhet të shkelë kursesi thelbin e së drejtës për ta ushtruar lirinë e tubimit.<sup>19</sup>

Ndërsa, Raporti i Zgjerimit i Bashkimit Evropian për Shqipërinë për vitin 2019, në kapitullin e të drejtave themelore parashikon shprehimisht se liria e tubimit dhe organizimit janë shprehimisht të parashikuara në Kushtetutë dhe legjislacionin për tubimet dhe janë në përgjithësi në linjë me standardet ndërkombëtare si dhe me Rregullat Kuadër të ODHIR-it mbi të drejtën për tubime paqësore. Gjatë periudhës së raportimit e drejta për tubime ishte përgjithësisht e garantuar, gjithsesi incidente u regjistruan në disa protesta dhe demonstrata politike<sup>20</sup>.

Në këtë kuptim, një qasje korrekte edhe në respektim të Kushtetutës e të instrumentave Ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut do të ishte rishikimi i kësaj mase, duke lejuar ushtrimin e të drejtës për të tubuar, nën garancinë e rregullave strikte të përcaktuara nga autoritetet, ashtu, siç në fakt, po veprohet për shumë masa të tjera kufizuese. Në vijim të këtij detyrimi dhe për t'u krijuar lehtësi shtetasve për realizimin e të drejtave të tyre kushtetuese e ligjore, por edhe për të unifikuar qëndrimin e organeve të Policisë së Shtetit, prokurorisë dhe atyre gjyqësore në të tilla raste, strukturat kompetente shtetërore duhet të përmirësojnë aktet normative që rregullojnë lirinë e tubimit, me qëllim që ajo të ushtrohet edhe në rastet e pandemive apo shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore.

Ndër eksperiencat pozitive të shteteve evropiane në këtë drejtim mund të përmendim Gjermaninë, e cila gjatë periudhës së pandemicë ka lejuar zhvillimin e grumbullimeve dhe tubimeve deri në një numër të kufizuar pjesëmarrësish duke ruajtur distancimin fizik gjatë situatave të tilla. Gjykata Kushtetuese Gjermane është shprehur mbi të drejtën e personave për të zhvilluar protesta, nëse zbatojnë rregullat e distancës fizike në mënyrë që e pengojnë

<sup>18</sup> Shih, *Sergey Kuznetsov kundër Ruisë*, nr. 10877/04, § 45, 23 tetor 2008.

<sup>19</sup> Shih, *Éva Molnár kundër Hungarisë*, 7 tetor 2008, kërkesa nr. 10346/05.

<sup>20</sup> Progres Raporti i BE për Shqipërinë, <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-albania-report.pdf>, f.10

përhapjen e infeksionit COVID -19 duke theksuar se një ndalim i përgjithshëm i tubimeve do të ishte jokushtetues dhe se shqetësimet shëndetësore të lidhura me pandeminë e koronavirusit nuk janë bazë për një ndalim të përgjithshëm të protestave<sup>21</sup>.

Për sa më sipër, Avokati i Popullit në vijim të kryerjes së misionit kushtetues e ligjor në rolin e nxitësit të standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend, bazuar në nenin 63/3 të Kushtetutës ku parashikohet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”; si dhe nenin 24/b të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Kur Avokati i Popullit vëren se është vetë përmbajtja e ligjit ose e akteve të tjera normative dhe jo zbatimi i tyre shkak që krijon premisa për shkelje të të drejtave të njeriut, të njohura nga Kushtetuta ose ligjet e tjera, ka të drejtë:

b. t’u propozojë organeve të administratës ndryshimin ose përmirësimin e akteve nënligjore; mosshqyrtimi i propozimit brenda 30 ditëve sjell si pasojë pezullimin e fuqisë së akteve nënligjore që shkaktojnë shkelje të të drejtave dhe lirive.”

### REKOMANDOJMË:

- Marrjen e masave të nevojshme për respektimin e të drejtës ligjore për tu takuar e mbrojtur me avokat shtetasve të arrestuar/ndaluar në organet e Policisë së Shtetit që në momentet e para të shoqërimit të tyre.
- Marrjen e masave të nevojshme për analizimin e shkeljeve ligjore gjatë shoqërimit e arrestimit të shtetasve B.P., si edhe tre aktivistët e lëvizjes Vetëvendosje në Shqipëri E.B., E.B. dhe Ç.G. me datë 11.04.2021, nga punonjësit e Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë, nxjerrjen e përgjegjësive ligjore ndaj personave përgjegjës dhe ndëshkimin e tyre me masa disiplinore.
- Vlerësimin dhe përgjithësimin e këtij rasti në strukturat e Policisë së Shtetit me qëllim mos përsëritjen në të ardhmen të shkeljes së të drejtave të personave të shoqëruar dhe arrestuar në ambientet e policisë.
- Marrjen e masave të nevojshme për ndërprerjen e menjëhershme të praktikës së deritanishme të strukturave të Policisë së Shtetit për moslejimin e grumbullimeve jomasive në vende të mbyllura ose të hapura, organizuar nga subjekte të ndryshme gjatë periudhës së pandemisë.

<sup>21</sup> Shih Vendimin e Gjykatës Kushtetuese Federale Gjermane  
[https://www.bundesverfassungsgericht.de/SharedDocs/Entscheidungen/DE/2020/04/rk20200415\\_1bvr082820.html](https://www.bundesverfassungsgericht.de/SharedDocs/Entscheidungen/DE/2020/04/rk20200415_1bvr082820.html)

Gjykojmë se referimi i saktë dhe zbatimi rigoroz i parashikimeve ligjore, sikurse edhe në këto raste, rrit efektivitetin në punë, shmang zvarritjen, si dhe krijon besueshmëri e organeve të administratës publike, në sytë e njerëzve të thjeshtë që presin respektimin e lirive dhe të drejtave të tyre legjitime.

Në përputhje me nenin 22, të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar me Ligjin Nr.9398 dt.12.05.2005, ku thuhet se;


“Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, kërkesë apo propozim për shkarkim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin, kërkesën apo propozimin për shkarkim dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit, kërkesës apo propozimit për shkarkim.

Përgjigja duhet të përmbajë shpjegime të arsyetuara për çështjen në fjalë, si dhe çfarë veprimesh, mosveprimesh apo masash ka ndërmarrë ai organ”,

kërkojmë të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor për qëndrimin tuaj, ndaj këtij rekomandimi.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin Tuaj, si edhe trajtimin e rekomandimit në përputhje me Ligjin,*

Konc. & Dak. E.P. 12.05.2021



**AVOKATI I POPULLIT**



**Erinda BALLANCA**